



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

PROCESVERBAL NR. 1

Rrogozhinë, më 30.01.2025 ora 13 : 00 °°

Zhvillohet mbledhja e radhës e shtyrë e Këshillit Bashkiak, në sallën e mbledhjeve të Këshillit në katin e dytë pranë ish Bashkisë Rrogozhinë.

Kjo mbledhje ishte thirrur dhe planifikuar të zhvillohej me datë 29.01.2024 ora 12:00 °° por për shkak se nuk u arrit kuorumi i nevojshëm i këshilltarëve mbledhja u shty për datë 30.01.2025 ora 13:00 °°.

Rendi i ditës :

Në mbështetje të Njoftimit, të thirrur nga Zëvendëskryetari i Këshillit Bashkiak z. Erind Tosku, me shkresën nr.365.Prot datë 23.01.2025 me rend dite si më poshtë :

- 1- Miratim i rendit të ditës.
- 2- Miratim i procesverbalit Nr.14, të mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 23.12.2024.
- 3- Miratim i procesverbalit Nr.15, të mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 27.12.2024.
- 4- Miratim i procesverbalit Nr.16, të mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 31.12.2024.
- 5- Shqyrtim i vlefshmërisë së mandatit të anëtarit të Këshillit Bashkiak z. Isa Halili.
- 6- Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Dhjetor 2024 nga fondi i Blllok - Ndhmës 6%”.
- 7- Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Janar 2025 nga fondi i pushtetit vendor”.
- 8- Miratim i projekt - vendimit, “Për përcaktimin e kriterëve dhe dokumentacionit për përfitimin e ndihmës ekonomike për familjet që nuk janë përfitues nga sistemi i pikëzimit, që do të trajtohen me ndihmë ekonomike duke përdorur deri në 6 % nga fondi i kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike për vitin 2025”.
- 9- Miratim i projektvendimit, “Për krijimin e komisionit për programet e strehimit social”.
- 10- Shqyrtim i problematikës së ndërprerjes së energjisë elektrike në Bashkinë Rrogozhinë.
- 11- Të ndryshme.
 - *Shqyrtim i ankesës së ardhur nga z. Hysen Xhaferrri.*

Marrin pjesë Këshilltarët prezentë në sallë :



Silvana Aliu, Besnike Coraj, Saimir Cani, Mitat Daja, Gezime Met-hasani, Lulzim Hasa, Alime Hoxha, Enver Memolla, Fatmira Thartori, Renato Kalemi, Erind Tosku, Mukades Gixhari.

Mungojnë :

Hekuran Xhani, Indrit Dedej, Lije Dedej, Merilin Saraçi, Isa Halili, Sokol Gosa, Lorena Baku, Altin Tosku, Shpati Kolgega.

Të ftuar :

1. Edison Memolla - Kryetar i Bashkisë.
2. Andi Proshka - Nënkryetar i Bashkisë.
3. Rezart Vogli - Drejtor i Financës.
4. Valmira Troka - Drejtore e Shërbimeve Mbështetëse.
5. Ledian Hasani - Drejtor i mbrojtjes dhe kujdesit social.
6. Marsida Thartori - Drejtore e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik.
7. Enkela Ballabani - Drejtore e zyrës Juridike.
8. Klea Dushku - Përgjegjëse e zyrës IT.
9. Sidorela Aliu - Specialiste e zyrës IT.

Drejton mbledhjen :

Mukades Gixhari – Kryetare e Këshillit.

Ndodhen në sallën e Këshillit Bashkiak : Këshilltarët e sipërcituar, si dhe specialistët e Bashkisë që janë thirrur për të shqyrtuar dhe relatuar pikat e rendit të ditës të sektorit që mbulon secili prej tyre, sipas axhendës ditore.

- Pasi konfirmohet kuorumi i nevojshëm, gjithsej 12- Këshilltarë. Znj. Silvana Aliu i bashkohet mbledhjes në minutëb e 5 të zhvillimit të saj.

HAPET MBLEDHJA

Mukades Gixhari . Përhëndetje të nderuar Këshilltarë ! Meqë kemi kuorumin e nevojshëm për mbledhje e deklaroj zyrtarisht të hapur. Marrin pjesë në mbledhje z. Erind Tosku, z. Renato Kalemi, znj. Fatmira Thartori, z. Enver Memolla, znj. Alime Hoxha, z. Lulzim Hasa, znj.



Gezime Met-hasani, z. Mitat Daja, z. Saimir Cani, znj. Besnike Coraj dhe Mukades Gixhari.
Gjithsej jemi 11-Këshilltarë. Lexojmë konfirmimin ligjor për vendimet e këshillit bashkiak me karakter normativ të datës 23.12.2024 ardhur nga Prefekti i Qarkut Tiranë.

Vendim nr .60, datë 23.12.2024 “Për përcaktimin e kriterëve për programin “Subvencionimi i Interesave të Kredisë”, konfirmohet.

Vendim nr .61, datë 23.12.2024 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Rrogozhinë për vitin 2025”, konfirmohet.

Vendim nr .62, datë 23.12.2024 “Për miratimin e realizimit Faktik të Buxhetit të vitit 2024 të Bashkisë Rrogozhinë. Konfirmohet në parim referuar ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Vendim nr .63, datë 23.12.2024 “Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 për Bashkinë Rrogozhinë. Konfirmohet në parim referuar ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Vendim nr .64, datë 23.12.2024 “Për miratimin e Buxhetit të Bashkisë Rrogozhinë për vitin 2025”. Konfirmohet në parim referuar ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

Vendim nr .66, datë 23.12.2024 “Për miratimin e Planit Vendor të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Bashkia Rrogozhinë”. Konfirmohet në parim referuar ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar dhe ligjit nr.10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.

Vendim nr .67, datë 23.12.2024 “Për miratimin e hartës së plazhit Spille dhe Vilë-Bashtovë, Bashkia Rrogozhinë në zbatim të Vendimit nr.649, datë 16.10.2024 për miratimin e Rregullores ‘Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit ‘ ’’, nuk konfirmohet referuar nenit 4 të VKM-së nr.649 datë 16.10.2024 “Për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e veprimtarisë së stacionit të plazhit”, pasi njësia e vetëqeverisjes vendore ka vetëm të drejtën e propozimit.

Vendim nr .68, datë 23.12.2024 “Për miratimin e Programit të Punës të Këshillit Bashkiak Rrogozhinë për vitin 2025”. Konfirmohet në parim referuar ligjit nr.139/2015” Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

Vendim nr .69, datë 23.12.2024 “Për miratimin e fondit të akorduar nga Këshilli i Ministrave për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”. Konfirmohet në parim referuar Aktit Normativ Nr.5, datë 19.12.2024 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.97/2023 “Për Buxhetin e vitit 2024” i ndryshuar.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin Prefekt Afrim Qendro.

Enver Memolla . Për procesverbalin, pika e kthyer mbrapsht mund ta dëgjoj dhe njëherë arsyen?



Mukades Gixhari . Vendimi nr .67, datë 23.12.2024 “Për miratimin e hartës së plazhit Spille dhe Vilë-Bashtovë, Bashkia Rrogozhinë në zbatim të Vendimit nr.649, datë 16.10.2024 për miratimin e Rregullores ‘Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit’ ”, nuk konfirmohet referuar nenit 4 të VKM-së nr.649 datë 16.10.2024 “Për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e veprimtarisë së stacionit të plazhit”, pasi njësia e vetëqeverisjes vendore ka vetëm të drejtën e propozimit.

Enver Memolla . Projektvendimi kur miratua na u tha që ishte çdo gjë konform ligjit dhe problem ishte vetëm Vila ndërkohë që dihet që kompetencat për bregdetin i ka marrë Ministria e Turizmit . Unë do doja të dija nga relatori i këtij projektvendimi pse nuk është i pranishëm sot për të dhënë shpjegimin nga ana ligjore sipas bashkisë së Rrogozhinës, Prefektit ja kemi marrë përgjigjen. Po se është hera e disatë dhe duhet të jetë relatori të relatojë po. Dalim tek çështja u mblodh këshilli nuk u mblodh këshilli, e miratoi këshilli se miratoi këshilli. Siç i miratojmë të na japin dhe përgjigje pse dalin të pavlefshme nga ana e bashkisë se juristët e prefekturës e kanë dhënë anën ligjore , se ligjshmëria e këshillit varet nga Prefektura, ligjshmëria e projektvendimit varet nga Bashkia. T’i bëjmë gjërat e qarta që mos thonë nesër nuk erdhi Veri nuk erdhi Alimeja apo dikush tjetër, të kemi respekt për veten tonë por dhe për punën që bëjmë këtu. Kryetare kur vjen miratimi i Prefektit vjen brenda 7-ditëve, maksimumi 10, duhet të ishin marrë masa për të gjitha që kjo mbledhje të kishte mbarëvajtje të rregullt dhe të kishte dhe përgjigje nga ana e bashkisë pse e sjell diçka që dihet që nuk është , unë këtu e kam. Falemiderit.

Mukades Gixhari . Mbledhjes ju bashkua znj. Silvana Aliu. Tani sapo lexuam konfirmimet ligjore të Prefektit të Qarkut Tiranë tani kemi, Vendimet me karakter individual që u morën në mbledhjen e këshillit të datës 23.12.2024 të cilat hyjnë në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“, i ndryshuar janë si më poshtë :

Vendim nr .57. Për dhënien e mandatit të anëtarit të Këshillit Bashkiak znj. Lorena Baku.

Vendim nr .58. Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Nëntor 2024 nga fondi i Bllok – Ndihmës 6% .

Vendim nr .59. Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Dhjetor 2024 nga fondi i pushtetit vendor.

Vendim nr .65. Për miratimin e listës së nxënësve që vazhdojnë studimet në Institucionet e Arsimit të Mesëm Profesional që Përfitojnë Bursë Shteti për vitin shkollor 2024-2025.

Kalojmë në leximin e konfirmimit ligjor për vendimin e këshillit bashkiak me karakter normativ të mbledhjes së datës 27.12.2024 të ardhur nga Prefekti i Qarkut Tiranë.

Vendim nr.70, datë 27.12.2024 ‘Për miratimin e Planit të Përmirësimit të Shërbimit për Arsimin Parashkollor Bashkia Rrogozhinë’. Konfirmohet.



Gjithashtu kemi dhe Vendimin me karakter individual që u mor në mbledhjen e këshillit të datës 31.12.2024 i cili hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“, i ndryshuar , si më poshtë :

Vendim nr .71, datë 31.12.2024 “Për miratimin e bursave të nxënësve të arsimit parauniversitar”.

Mukades Gixhari . Tani do kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës. Miratim i rendit të ditës. E hedhim në votim. Pro, kundër, abstenim? Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 12 (dymbëdhjetë) vota pro, 0 (zero) vota kundër, 0 (zero) vota abstenim, pika 1 (një) e rendit të ditës .

Mukades Gixhari . Miratim i procesverbalit Nr.14, të mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 23.12.2024. E hedhim në votim. Pro, kundër, abstenim. Të gjithë pro. Miratohet. Faleminderit.

-Miratohet me 12 (dymbëdhjetë) vota pro, 0 (zero) vota kundër, 0 (zero) vota abstenim, pika 2 (dy) e rendit të ditës .

Mukades Gixhari . Miratim i procesverbalit Nr.15, të mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 27.12.2024. E hedhim në votim. Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 12 (dymbëdhjetë) vota pro, 0 (zero) vota kundër, 0 (zero) vota abstenim, pika 3 (tre) e rendit të ditës .

Mukades Gixhari . Miratim i procesverbalit Nr.16, të mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 31.12.2024. E hedhim në votim. Pro, kundër, abstenim? Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 12 (dymbëdhjetë) vota pro, 0 (zero) vota kundër, 0 (zero) vota abstenim, pika 4 (katër) e rendit të ditës .

Mukades Gixhari . Jemi në pikën 5, Shqyrtim i vlefshmërisë së mandatit të anëtarit të Këshillit Bashkiak z. Isa Halili. Pra në lidhje me këtë pikë, sikurse ju është vënë në dispozicion të gjithëve kemi një kthim përgjigje nga Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve ku na janë vënë në dispozicion dy dokumente : Vendimi 191 datë 11.05.2023 i KZAZ-së Nr. 43 “Për emërimin e anëtarëve të KQV-së” dhe Procesverbali i mbylljes së QV-së Nr.2232 për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023, pra që vërtetojnë që Këshilltari z. Isa Halili ka qenë anëtar i QV-së nr.2232. Gjithashtu kam dhe procesverbalin e komisionit të mandateve ku propozohet heqja e mandatit të këshilltarit Isa Halili pasi bie ndesh me ligjin.



Mesa kam ndjekur mbledhjen e datës 23.12.2024 nga këshilltari Isa Halili na u tha që do të na sillte prova dhe dokumente shtesë në lidhje me këtë çështje. Ka sjell ndonjë informacion?

Ervis Shera . Jo.

Mukades Gixhari . Po z. Lulzim Hasa.

Lulzim Hasa . Kur një anëtar këshilli bashkiak është anëtar i komisionit zgjedhor ose të numërimit, taksative nuk duhet të jetë anëtar këshilli bashkiak. Çfarë dokumentash shtesë mund të ketë ky? Ose ai mund të ketë tjetër por kjo është taksative, ja dhe KQZ ka aprovuar kështu që...

Silvana Aliu . Duke qenë se me komisionin e mandateve kemi folur dhe presim që të sjelli provat ne e kemi lënë këtë mbledhje dhe presim mbledhjen tjetër që t'i marrë të gjitha .

Alime Hoxha . Nuk besoj se ka shumë nevojë për provat e tij sepse këtu është Isa Halili anëtar pro dhe me firmën e tij, pra kjo e ka vërtetuar që ai ka qenë anëtar i qendrës së votimit jo i qendrës së numërimit kjo është një shkresë që ka ardhur nga KQZ-ja dhe e ka shumë të qartë që z. Isa Halili ka qenë anëtar i këtij komisioni sepse ka firmosur në mbylljen e procesverbalit. Tani meqenëse po kërkojmë që ai të vazhdojë, unë mendoj të ja lejmë hapësirën që dhe ai të reflektojë dhe të marrë vendimin që atij i duket më i drejtë për veten e tij se besoj se pas heqjes nga Këshilli kjo ka dhe procedura të tjera nga mbrapa. Apo jo Vis? Nëse ne i heqim mandatin ku e ai e ka fituar në mënyrë të padrejtë?

Ervi Shera . Nëse do ndërmerri procedura të tjera është po në dorën e këshillit.

Silvana Aliu . Gjithsesi ne e vendosëm të presim materialet ai thotë kam prova, presim provat.

Lulzim Hasa . Mbyllja e procesit të votimit është përfundimtare dhe të gjithë anëtarët e qendrës së votimit firmosin kur mbyllet qendra e votimit, më tej se kjo nuk ka mundësi. Qendra e votimit është mbyllyr në orën 8 ose 9 dhe unë kam firmosur që kam qenë anëtar i komisionit dhe kur do bëhet dorëheqja në 12 të natës? Thjeshtë unë po jap argumente...

Alime Hoxha . Ne ja lejmë të drejtën të sjellë provat.

Lulzim Hasa . Ne jemi të gjithë që zbatojmë ligjin kur ne shkelim ligjin për veten tonë atëherë çfarë pret populli nga ne? Është takasative nuk ka vend për evazion hyr atje dil këtu.



Mukades Gixhari . Meqë komisioni i mandateve ka propozuar dhe e ka lënë për mbledhjen e radhës do sjelli informacionin atëherë do ta shtyjme për mbledhjen e radhës. Vazhdojmë me pikën 6, miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Dhjetor 2024 nga fondi i Bllok - Ndhmës 6%”. Relaton drejtori i Mbrojtjes dhe Kujdesit Social z. Ledian Hasani.

Ledian Hasani . Kemi 18 familje dhe fondi është 83 mijë lekë të reja për muajin Dhjetor 2024.

Mukades Gixhari . Ndonjë pyetje rreth kësaj pike të rendit të ditës? E hedhim në votim. Pro, kundër, abstenim? Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 12 (dymbëdhjetë) vota pro, 0 (zero) vota kundër, 0 (zero) vota abstenim, pika 6 (gjashtë) e rendit të ditës .

Vendim nr.1. Miratohet me 12-vota pro, projektvendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë me shkresë Nr.351.Prot datë 22.01.2025 “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Dhjetor 2024 nga fondi i Bllok – Ndhmës 6%”, si dhe Relacioni shpjegues për këtë projektvendim me Nr.351.Prot datë 29.01.2025.

Mukades Gixhari . Miratimi i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Janar 2025 nga fondi i pushtetit vendor”. Vazhdojmë po me drejtorin e Mbrojtjes dhe Kujdesit Social z. Ledian Hasani.

Ledian Hasani . Kemi 21 familje dhe fondi është 103 mijë lekë të reja.

Enver Memolla . Gjatë gjithë muajit pothuajse kemi komunikim thuajse dy herë në ditë. Ne me të vërtetë i miratojmë këto ndihma kryetare por kjo që ka ndodhur në muajin Janar nuk ka ndodhur ndonjëherë në Bashkinë Rrogozhinë për të gjithë njësitë, data 29 Janar dhe erdhën borderotë e ndihmës ekonomike, dje. Unë nuk arrij ta kuptoj mënyrën e funksionimit të Institucionit midis zyrave apo dikastereve çfarë mund të jenë por një gjë më ka acaruar dhe më ka ngjall neveri sorollatja që i është bërë njerëzve nga zyrat apo nga punonjësit, i kemi çuar borderotë si kemi çuar borderotë e lagu se lagu, hipi apo zbriti. Këto që janë këtu nuk është se janë të pasur dhe për 80 mijë lekë të vish të sorollatesh sa tek posta, sa në Komunë e sa në Bashki ky është një turp, është realisht turp. Në të vërtetë ka pasur një problematikë brenda, tregoji qytetarit problematikën që është mos i sorollat në institucion tjetër që përplasem unë që jam aty apo kolegët e mi, nëpër njësi. Sepse realisht këto nuk janë për t’u kaluar sot me këtë që keni bërë këtë muaj, se kush e ka fajin gjejeni ju. E dini shumë mirë që kjo digjet brenda muajit ndihma e plot.



Ledian Hasani . Një koleg i joni ka pasur probleme shëndetësore.

Enver Memolla . Bashkia Rrogozhinë ka 380 punonjës.

Ledian Hasani . Është me sistem nuk mund të firmosi një tjetër.

Enver Memolla . Po me vlla por vdiqa unë nesër kush do firmosi ?

Ledian Hasani . Kolegu nuk është se ka vdekur.

Enver Memolla . Mos i sorollasni njerëzit.

Ledian Hasani . Nuk ka sorollatje tek njerëzit, njerëzit janë mësuar me datat që vijnë tek posta , pastaj ne kemi pasur problem dhe me postën në Gosë i kemi nisur borderotë ato kanë dy muaj që i mbajnë borderotë. Njerëzit vijnë se janë mësuar me datat nuk i ka thënë njeri njerëzve që shkoni tek Veri. Problemi është i kolegut tonë, kolegu ka pasur probleme shëndetësore normalisht kjo është e gjithë pengesa nuk ka pasur pengesë tjetër.

Renato Kalemi . Mirë në këto raste nuk mund të ja delegosh firmën dikujt tjetër?

Ledian Hasani . Nuk mund ta delegojë ai se është firmë në sistem që e ka thesari . Do 20 ditë të miratohet firma. Ver meqë jemi tek kjo pjesa atë pjesën e postës si do e zgjidhim sepse ne kur i nisim borderotë ti sjell unë ty tek posta dhe ato tek komuna vijnë e ankohen kur ne e kemi sjellë borderonë.

Enver Memolla . Është bërë ajo mbledhje dhe do marri zgjidhje.

Ledian Hasani . Të paktën kemi pasur probleme në Gosë dhe në Lekaj.

Erind Tosku . Këto shqetësime që keni na veni në dijeni.

Ledian Hasani . Me Verin kam folur.

Mukades Gixhari . Atëherë diskutim tjetër? E hedhim në votim. Pro, kundër, abstenim. Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 12 (dymbëdhjetë) vota pro, 0 (zero) vota kundër, 0 (zero) vota abstenim, pika 7 (shtatë) e rendit të ditës .



Vendim nr.2. Miratohet me 12-vota pro projekt-vendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë, me shkresë Nr .350. Prot datë 22.01.2025 , “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Janar 2025 nga fondi i pushtetit vendor”, si dhe Relacioni shpjegues i këtij projektvendimi me Nr.350/1.Prot datë 29.01.2025.

Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën 8, miratim i projekt - vendimit, “Për përcaktimin e kriterëve dhe dokumentacionit për përfitimin e ndihmës ekonomike për familjet që nuk janë përfitues nga sistemi i pikëzimit, që do të trajtohen me ndihmë ekonomike duke përdorur deri në 6 % nga fondi i kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike për vitin 2025”. Vazhdojmë po me drejtorin e Mbrojtjes dhe Kujdesit Social z. Ledian Hasani.

Ledian Hasani . Atëherë këto janë po ato kritere që kemi miratuar vit për vit, janë kriteret e 6 % . Kriteret janë ato që kam shkruar tek projektvendimi.

Mukades Gixhari . Ndonjë pyetje diskutim? E hedhim në votim. Pro, kundër, abstenim? Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 12 (dymbëdhjetë) vota pro, 0 (zero) vota kundër, 0 (zero) vota abstenim, pika 8 (tetë) e rendit të ditës .

Vendim nr .3. Miratohet me 12-vota pro projekt-vendimi i ardhur nga Kryetari i Bashkisë, me shkresë Nr .345.Prot datë 22.01.2025 ,“Për përcaktimin e kriterëve dhe dokumentacionit për përfitimin e ndihmës ekonomike për familjet që nuk janë përfitues nga sistemi i pikëzimit, që do të trajtohen me ndihmë ekonomike duke përdorur deri 6 % nga fondi i kushtëzuar për bllok ndihmën për vitin 2025”, si dhe Relacionin shpjegues për këtë projektvendim me Nr.345/1.Prot datë 29.01.2025.

Mukades Gixhari . Kalojmë në pikën 9, miratim i projektvendimit, “Për krijimin e komisionit për programet e strehimit social”. Vazhdojmë po me drejtorin e Mbrojtjes dhe Kujdesit Social z. Ledian Hasani.

Ledian Hasani . Atëherë siç jua kam shpjeguar dhe tek relacioni ky komision ka lidhje me programet e strehimit , një program është dhe ai i kredive të buta që ne kaluam para një muaji. Knë filluar dhe aplikimet për atë pjesë ka njerëz që kanë aplikuar por që tabëjmë me qenë në rregull duhet me u ngritur ky komisioni prej 7 personash. Personat që do jenë tek ky komision duhet të jenë përfaqësues i komuniteteve të interesuar për pjesën e kredive të buta dhe programeve të tjera që do jenë në vijim . Edhe programet tjera do t'i kalojmë ne në këshill bashkiak.



Silvana Aliu . Atëherë ne kërkojmë ngritjen e një komisioni paralelisht nga këshilli bashkiak para se të vijë këto emra në këshill për t'u votuar. Komisioni paralelisht me këto para se të vijë emrat në këshill bashkiak t'i bëhet një verifikim. Mos përfundojmë si listat e tërmetit që erdhën u votuan, para se të vijë ato ne t'i verifikojmë pastaj...

Lulzim Hasa . Derisa këshilltarët kanë akses në komisionin e ekonomisë përbëhet pozitë opozitë të gjithë rezervat që kanë për emrat.

Silvana Aliu . Çfarë të keqe ka ngritja e një komisioni? Po mirë ato le ta bëjnë punën e tyre kur a kenë mbaruar punën të vijë dhe ... Atëherë do ngrehet komisioni do i bëni verifikimet, do na sillni emrat, para se të vijë për votim ne do të ngrejme një grup komisioni si këshill bashkiak do i verifikojmë vetë ... Jo mbasi janë votuar, para se të votohen.

Lulzim Hasa . A ke komision ekonomie? Pastaj ato dalin në bazë të pikëzimit.

Silvana Aliu . E kemi parë sistemin e famshëm të juajin ne po themi këtë gjë ju thoni sistemi sistemi! E kemi parë që gjithë kreditë e buta deri tani i kanë marrë po administrata juaj, mos na lodhni.

Ledian Hasani . Administrata do aplikojë.

Silvana Aliu . Nuk është administrata juaj njësoj me atë që është i varfër, me atë që nuk ka mundësi.

Erind Tosku . Ti do ti lësh çiftet e reja me pleq në shtëpi, lëri të dalin më vete.

Famira Thartori . Anëtarët e komisionit ishin 7. Çfarë kriteresh duhet të plotësojë një anëtar komisioni për të qenë pjesë e këtij komisioni?

Ledian Hasani . Jam unë, duhet një ekonomist nga zyra e financës që do bëjë llogarinë e të ardhurave që ka familja nga drejtoria juridike një përfaqësues jurist që do merret me anën juridike, politikave urbane më tepër ka lidhje me pjesën e dëmtimit të banesës . Pjesa e kryetarit të invalidëve të punës për të njoftuar pjesën e invalidëve të paafteve që në bashkinë Rrogozhinë ka programe ... përfaqësues të komunitetit rom dhe egjiptian po ashtu .

Fatmira Thartori . Sa për të sqaruar të gjithë publikun që na dëgjon, komisioni 4 janë , 3 sa janë të bashkisë.



Ledian Hasani . 4 të bashkisë.

Fatmira Thartori . Dhe janë të përcaktuar të tjerët pra një është rom ... Këtë po them unë ato që po na dëgjojnë tani dhe kanë interes për t'u bërë anëtarë këto pika duhet t'i komunikoni.

Silvana Aliu . Emri që do përfaqësojë komunitetin rom?

Ledian Hasani . Një vajzë, i kam marrë deklaratën.

Silvana Aliu . Po emri?

Ledian Hasani . Po unë nuk do mbaj mend ... hajde atje nesër dhe ta them unë kush është. Herë të tjera e kemi kaluar këtë komisionin nëse mban mend o Ver e kemi kaluar dhe vjet dhe parvjet nuk është bërë kaq e madhe.

Mukades Gixhari . Ne jse mos dalim jashtë kornizës së mbledhjes. E hedhim në votim. Pro, kundër, abstenim. Atëherë të gjithë pro. Miraothet.

-Miratohet me 12 (dymbëdhjetë) vota pro, 0 (zero) vota kundër, 0 (zero) vota abstenim, pika 9 (nëntë) e rendit të ditës .

Vendim nr .4. Miratohet me 12-vota pro, projekt-vendimin e propozuar nga Kryetari i Bashkisë, me shkresë Nr.273.Prot datë 20.01.2025 , “Për krijimin e komisionit për programet e strehimit social”, si dhe Relacioni shpjegues për këtë projektvendim me Nr.273/1.Prot datë 20.01.2025.

Mukades Gixhari . Ledian të falenderoj. Vazhdojmë me pikën 10, Shqyrtim i problematikës së ndërprerjes së energjisë elektrike në Bashkinë Rrogozhinë. Të nderuar Këshilltarë ne i kemi çuar një kërkesë me shkrim drejtorisë së elektrikut në Durrës pasi atje është ajo kryesorja që ne të na japë llogari për të gjithë këto probleme por meqë nuk janë prezentë mendoj që të mos ndalemi por ta lejmë për mbledhjen e radhës.

Mitat Daja . Unë mendoj të bëjmë një deklaratë që këshilli bashkiak për problematikat që sjell ndërprerja e energjisë sepse është problem shumë i madh nuk është problem i vogël . Të bëhet një deklaratë nuk e di tani sekretari e formulon një deklaratë dhe ne e firmosim nuk e kam idenë se si mund të funksionojë por pa gjë fare nuk do lënë, deri kur t'i teket atyre që të vijë ka mbaruar koha. Prandaj është mirë që ne ta bëjmë një deklaratë ta dinë që këtu ka njerëz ne jemi



përfaqësues të këtyre njerëzve që po vuajmë këtë lloj problematike, sidomos fshatrat janë edhe më keq. Plus tensioni i ulët, plus ndërprerja plus problematika tjera, kush ka dhe biznese e vuan edhe më tepër sepse ndodhin shumë probleme. Pra unë mendoj mos e lejmë të presim kur t'i mbushet mendja atyre se ato janë të mëdhenj nuk vijnë dot këtu tek ne, po të bëjmë një deklaratë ta hartojmë si këshill bashkiak ta firmosim të ja çojmë me postë apo në rrugë zyrtare tjera si funksionon dhe ata pastaj të bëjnë çfarë të duan. Ne si përfaqësues të njerëzve kemi bërë punën tonë, kjo nuk është për hipokrizi kjo është thjeshtë se kaq është mundësia jonë, të bëhet një. Mendoj që ata përfaqësuesit nuk do vijnë ne ta bëjmë një deklaratë.

Enver Memolla . Tani në mbështetje të dy kolegëve dhe Mitatit dhe Erindit, unë nuk mendoj deklaratë mendoj kërkesë zyrtare nga Këshilli Bashkiak për këtë pjesë qoftë dhe mbledhjen e radhës por dhe mbledhje jashtë radhe se është një gjë që nuk është se pret më. Sidomos javën e fundit hajde e ik, digjen pajisje familjare rrezik shkëndijash kështu që një shkresë tjetër prap deri kur të vijnë. Se është një pjesë sidomos për fshatrat Lekaj, Gosë është nxirë komplet nuk e di për Kryevidhin.

Mukades Gixhari . Në rregull. Vazhdojmë me pikën 11, Të ndryshme. Shqyrtim i ankesës së ardhur nga z. Hysen Xhaferri. Kemi një ankesë nga z. Hysen Xhaferri ish kryetar i fshatit Kërçukaj Njësia Administrative Gosë, ku shprehet që zgjedhjet e kryetarit të ri të fshatit kanë qenë jo normale dhe të njëanshme. Për të shqyrtuar këtë çështje kam thirrur ish administratoren e Njesisë Gosë znj. Valmira Troka, gjithashtu kemi prezente dhe anëtarën e Këshillit znj. Besnike Coraj të cilat kanë monitoruar zgjedhjet e kryetarit të fshatit Kërçukaj për mandatin 2023-2027. Tani znj. Valmira çerek ore para se të fillontë ,bledhja i dli një takim për në Tiranë edhe nuk është e pranishme. Po z. Lulzim Hasa.

Lulzim Hasa . Për zgjedhjen e kryetarëve të fshatit, unë kam qenë drejtuesi i zgjedhjeve në Kryevidh aty kanë asistuar anëtarët e këshillit besoj. Ato anëtarët e këshillit që kanë qenë aty e vërtetojnë është manipuluar s'është manipuluar.

Enver Memolla . Janë 3.

Lulzim Hasa . Pa tre firma të anëtarëve të këshillit nuk quhet e mirëqenë.

Besnike Coraj . Ishim bashkë me Fatmirën por Fatmira për arsyet e saj familjare kishte një arsye familjare dhe u largua në moment. Në një moment pastaj mendova të pezullohej sepse kishte grindje debate ishin grumbulluar dhe njerëz disa persona të lagjes ishin grumbulluar për votimin thanë përse, më pyetën cili është roli jot në këtë...? I thashë si vëzhguese se si do bëhet votimi.



Atëherë thanë ti na njeh shumë mirë që ne jemi anëtarë të kësaj lagjeje përse e anulon votimin? Ok, i thashë doni të vazhdoni e vazhdoni edhe u bë votimi me copa letre unë nuk kam parë ndonjëherë, por ashtu gjithë anëtarët u mbajt dhe një procesverbal në të njëjtën kohë ishte dhe vetë zotëria që... unë tani po e lexoj letrën. Ky ishte i pari do shkarkohej do vendosej tjetri. U bë votimi i rregullt siç thashë me copa letre me gjëra. Kishte pjesëmarrje edhe femra edhe meshkuj, kishte goxha nga lagjja s'di çtë them më tjetër, unë tani po e lexoj këtë që ka shkruar. Aty ishte dhe zotëria disa herë ja bëra të qartë... Bënë debate nuk di çfarë të them se nuk futem në gjëra të tilla, pati debate kjo ishte dhe arsyeja që unë edhe pasi u largua Fatmira që ndodhesha vetëm me Valmirën, i thashë e pezullojmë. U ngrit njëri nga anëtarët e lagjes, pjesëmarrësit aty dhe tha , kush është roli jot këtu mu drejtua? - I thashë të vëzhgoj mënyrën e... Atëherë ti na njeh që të gjithëve tha. A jemi banorë të lagjes ? - Po i thashë. Ti përse e ndërpret votimin, vazhdojmë votimin. Ok i thashë, edhe vazhduan. Kjo ka qenë arsyeja. Zotëria pati ankesa, kishte pakënaqësi edhe aty ku ishte bënte debate fjalët e tyre.

Lulzim Hasa . Çfarë kërkon nga ne?

Enver Memolla . Ky kërkon shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve, të ketë zgjedhje tjera as ky as ai tjetri kandidat të jenë kandidatë të tjerë.

Besnike Coraj . Ai kishte disa pretendime është njëri i respektuar që të dy, kishte ca pretendime që unë dua ta mbaj vetë po vetëm kam kështu pse ta marri ky, disa gjëra që nuk e di që aty i kam parë dhe po habitem.

Lulzim Hasa . Në një fshat dy kandidatë në fund i dha dorën, hajde kush ta fitojë i dha dorën nuk ka ndonjë të keqe.

Enver Memolla . Unë faktikisht kisha diçka por ktheva kokën nuk qenka drejtori i bujqësisë edhe e lashë.

Lulzim Hasa . Çfarë drejtimi do i japim kësaj?

Enver Memolla . Drejtimi është dhënë.

Mitat Daja . Unë po pyes është ai drejtori i punësve publike këtu apo nuk është? Apo ka përfaqësues Arditin, ka sjellë përfaqësues. Kam një pyetje Ardit, a ka elektrikistë Bashkia e Rrogozhinës? Po ka më shumë se një muaj ato dritat në hyrje të Rrogozhinës as nuk ndizen as nuk fiken. Keni shumë që po merreni? Drejt përfundimit, shpresojmë. Edhe një pyetje tjetër



Ardit meqë me këtë po merreni, po një rrugë që po shembet atje se është rrezik dhe për ty që kalon atje ke vënë re ndonjëherë, tek ujësjellësi? Nuk merrni asnjë lloj mase ju për këtë? Do merreni, tek ujësjellësi aty tek Ndërtim Jaupaj, nuk do merrni deri sa të vdesi ndonjë njeri sdo merrni asnjë masë për atë. Sepse mund të bjerë ndonjë njeri me makinë natën aty. Apo nuk bie? Se keni rrugë të përhershme ajo mjafton me pak beton mund të bëhet, është e habitshme. Kthehen projektvendimet tona nga Prefekti për moskompetencë tani ne nuk jemi jurista, drejtoresha juridike duhet të vi të na thotë pse e sjell këtë gjë kështu ose të na arsyetojë që Prefekti ja ka futur kot është ngatërruar me një gjë tjetër, po flas pak kështu tani dhe nuk kuptim...

Lulzim Hasa . Nuk është ndonë tragjedi Mitat, po kthehen vendime projektligjet e deputetëve po kthehen disa hera, s'ka asnjë të keqe.

Mitat Daja . Unë kam parë që këshilli bashkiak nuk i ka penguar ndonjëherë bashkisë punë.

Lulzim Hasa . Jo.

Mitat Daja . Biles ka qenë ndihmës edhe ka dalë dhe nga vetja për ta ndihmuar bashkinë.

Lulzim Hasa . Do ta zgjidhësh ti? -Ne kemi të drejtë ta çojmë dhe për së dyti dhe Prefekti s'ka të drejtë, Prefekti i drejtohet gjykatës administrative. Kanë zgjidhje gjërat nuk është katastrofë. Kalon një projektligj në parlament shihe ti sa herë e kthen presidenti mbrapsht, disa ligje.

Alime Hoxha . Në fakt tek të ndryshmet kisha disa problematika që kanë të bëjnë me shkollat doja në fakt drejtoreshën e shërbimeve por nuk qenka sot këtu. Meqë e nisëm tek dritat Ardit edhe nëpër shkolla kemi disa djegie të neoneve në Stërbeg në Luz, tjetër tek pajisjet sanitare nuk është vënë dorë, kaldaja në Gosë nuk është vënë fare në funksionim këtë vit nuk e di ka munguar nafta. Në Vilë Bashtovë është prishur sistemi i kondicionerëve atje ka 1 muaj dhe akoma nuk është rregulluar, më tha drejtori ka bërë kërkesa për disa rezistenca, të paktën krijoni kushte se janë fëmijët nga klasa e parë në klasë të katërt. Dru nëpër shkolla tani po i merr ti të gjitha nuk e di , apo do i mbash ti Vis shënim, kanë shkuar drutë por drutë e fundit që kanë shkuar kanë qenë copa dërrasash dhe pothuajse kanë mbaruar nuk ka. Të paktën dhe muaji Shkurt duhet të ketë të sigurojmë ngrohjen e atyre. Edhe tek kopshti i Kryevidhit shtë çarë një tub uji atje ka dy javë akoma nuk po gjendet zgjidhje. Kaldaja tek gjimnazi pati një problem për pastrimin por akoma nuk ishte rregulluar kështu që akoma nuk është vënë në funksionim po ashtu terreni sportiv i gjimnazit. Nuk e di çfarë po bëhet kanë filluar punimet akoma nuk kanë mbaruar . Unë doja drejtoreshën që të ja thoja të gjitha, meqë nuk ka njeri tjetër të paktën të merren prasysh.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

Lulzim Hasa . Bëja zyrtare.

Alime Hoxha . Do ja bëj Valit.

Lulzim Hasa . Zgjidhe me shkrim, protokolloje.

Alime Hoxha . Dhe një gjë tjetër kam prap po për këtë të administratës së bashkisë. Tani këto pusetat e qytetit duhet të shikohen të pastrohen të rregullohen para se të bjerë shiu se bllokohen rrugët aty. Të gjitha këto puseta se mua më rastis ngaqë vi në këmbë nga kjo rruga këtej po ti shikosh të gjitha këto puseta janë të bllokuara dhe uji është i gjithi në rrugë. Edhe një problem po ndërtohet ai pallati aty, ato nxjerrin ujë e hedhin në trotuar pra e nxjerr tubin deri tek trotuari nuk paska një tubë që ta çojë atë deri tek puseta ku mbushet gjithë trotuari dhe gjithë ajo rruga aty me ujë. T'i vihet një kusht atj zotërisë që e nxjerr ujin aty zgjate tubin çoje deri tek puseta të futet uji në pusetë, nuk e di se si nuk ju bën përshtypje ju, se ju të gjithë aty kaloni. Ju jeni të gjithë aty përpara çdo ditë ajo mbushet me ujë dhe asnjëri nuk merr masa për ta rregulluar këtë problem, këto kisha.

Mukades Gixhari . Ndonjë gjë tjetër? Meqë nuk kemi gjë tjetër për të diskutuar mbledhjen e deklaroj zyrtarisht të mbyllur.

MBYLLET MBLEDHJA

- Mbledhja deklarohet e mbyllur zyrtarisht rreth orës 14 : 00^{oo} . Video regjistrimi i kësaj mbledhjeje zgjati rreth 46 min ; 41 sek.
- Ky procesverbal mbyllet në faqen 15 (pesëmbëdhjetë).

Miratohet procesverbali :

Zbardhi (transkriptoi) procesverbalin :
Sekretari i Këshillit
Ervis Shera